



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2022:215889

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06277869

C.nr. 952/2022

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI, gjyqtari, Arben Xheladini, me bashkëpunëtorin profesional Agon Halabaku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, U.M., nga fshati D., Komuna e Vitisë, kundër të paditurit, F.I., nga fshati S., Komuna e Vitisë, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, jashtë seancës, më datë 10.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hidhet poshtë padia e paditësit, U.M., kundër të paditurit, F.I., me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë.

A r s y e t i m

Paditësi, U.M., me padinë e dorëzuar më datë 19.10.2022, ka kërkuar të vërtetohet se është pronar i ngastrës kadastrale 00826-0, në vendin e quajtur “S.”, në sipërfaqe prej 778 m², Zona Kadastrale D..

Shkresat e dërguara në adresën e të paditurit, F.I., në fshatin S., janë kthyer të pa dorëzuara, me konstatimin se është i vdekur. Këtë fakt, gjykata e ka vërtetuar me Certifikatën e Vdekjes, me numër të serisë V 10702559, numër reference 4/2020RV/4001 dhe numër rendor 100, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, në Gjilan, sipas të cilës F.I. ka vdekur më datë 06.02.2020

Duke qenë se në kohën e dorëzimit të padisë në gjykatë, i padituri veçse ka qenë i vdekur, me aktvendimin e datës 16.08.2024, gjykata, duke u bazuar në nenin 78.1 të LPK – së, “Kur gjykata konstaton se personi që paraqitet si palë nuk mund të jetë palë në procedurë, dhe se kjo mungesë mund të evitohet, do ta ftojë paditësin që të bëjë ndreqje të nevojshme në padinë ose do të ndërmarrë masa të tjera me qëllim që procedura të mund të vazhdohet me personin që mund të jetë palë në procedurë”, ia ka kthyer paditësit padinë për ta rregulluar në aspektin e legjitimitetit juridik real pasiv, në mënyrë që si të paditur t’i përfshijë trashëgimtarët ligjor të F.I.t. Në këtë aktvendim, paditësi është paralajmëruar me pasojat ligjore në rast se brenda afatit të caktuar prej 30 ditësh nuk i ndërmerr veprimet.

Pas kontrollimit të shkresave të lëndës, gjykata ka konstatuar se aktvendimin e datës 16.08.2024, në tentimin e dytë më datë 23.08.2024 e ka panuar M.M.– vajza e paditësit, afati tashmë ka kaluar pasi dita fundit për të vepruar ka qenë data 23.09.2024 (e shtyrë për një ditë sipas nenit 126.5 të LPK-së meqë data 22.09.2024 kur ka mbaruar afati i caktuar ka qenë e diele), ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka asnjë parashtrësë të paditësit, me të cilën do të vërtetohej se i ka ndërmarrë veprimet dhe/ose e ka kërkuar shtyrjen e afatit.

Dorëzimin e parashtrësës anëtarit të familjes gjykata e konsideron të rregullt sepse janë konsumuar veprimet sipas nenit 110.2 të LPK-së: tentimi i parë për dorëzim është bërë më datë 21.08.2024,

ndërsa më datë 23.08.2024 aktvendimi është pranuar nga familjari i paditësit ashtu siç përcaktohet me nenin 111.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, e bazuar në nenin 78.4 të LPK – së, sipas të cilit: “Po që se të metat e treguara nuk mund të mënjanojnë, apo në qoftë se afati i caktuar nga gjykata kalon pa sukses, gjykata me aktvendim i abrogon veprimet e kryera po që se janë përfshirë me të metat në fjalë dhe do ta hedhë poshtë padinë, po që se të metat kanë natyrë të tillë që pengojnë procedimin e mëtutjeshëm të çështjes” lidhur me nenin 387.1 pika s), të LPK – së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA VITI
C. nr.952/2022 datë 02.10.2024

Gj y q t a r i,

Arben Xheladini

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj gjykate.